**KOMBET E BASHKUARA**

Tribunali Ndërkombëtar për Ndjekjen Penale të Personave Përgjegjës për Shkelje të Rënda të së Drejtës Humanitare Ndërkombëtare të Kryera në Territorin e ish-Jugosllavisë prej Vitit 1991

Lënda Nr. IT-04-84-T

Data: 7 shtator 2007

Origjinali: anglisht

**NË DHOMËN GJYQËSORE I**

**Para:** **Gjykatësit Alphons Orie, Kryegjykatës**
**Gjykatësit Frank Höpfel**
**Gjykatësit Ole Bjørn Støle**

**Sekretari:** **Z. Hans Holthuis**

**Vendim i datës:** **7 shtator 2007**

**PROKURORJA**

**kundër**

**RAMUSH HARADINAJT**
**IDRIZ BALAJT**
**LAHI BRAHIMAJT**

***PUBLIK***

# URDHËR DREJTUAR PROKURORISË PËR HETIM ME SYNIM PËRGATITJEN DHE PARAQITJEN E AKTAKUZËS PËR SHPËRFILLJE

**Zyrës së Prokurores:**

Z. David Re
Z. Gramsci di Fazio
Z. Gilles Dutertre
Z. Philip Kearney

**Avokatëve të Ramush Haradinajt:**

Z. Ben Emmerson, QC
Z. Rodney Dixon
Zj.Susan Park

**Avokatëve të Idriz Balajt:**

Z. Gregor Guy-Smith
Zj. Colleen Rohan

**Avokatëve të Lahi Brahimajt:**
Z. Richard Harvey
Z. Paul Troop

1. Më 18 maj 2007 Prokuroria në çështjen *Prokurorja kundër Ramush Haradinajt dhe të tjerëve/Prosecutor v. Ramush Haradinaj et al*, bëri kërkesë për lëshimin e një urdhërparaqitje për të dëshmuar për një dëshmitar të propozuar i cili refuzoi të paraqitet para Tribunalit.("Kërkesa e Prokurorisë")[1] Në kërkesë thuhet se një hetues i Prokurorisë shkoi në shtëpinë e dëshmitarit dy herë në shkurt të vitit 2007, mirëpo nuk mundi të takohej me dëshmitarin. Herën e parë një i afërm i dëshmitarit i tha hetuesit se dëshmitari nuk ishte në shtëpi dhe se ai nuk do të ishte "në shtëpi për TPNJ-në".[2] Gjithashtu i afërmi i tha hetuesit se dëshmitari "është plak dhe nuk di kurrgjë" dhe se dëshmitari vuante prej tensionit të lartë.[3] I afërmi deklaroi se të tëra kontaktet me dëshmitarin duhej të kalonin nëpërmjet një të afërmi tjetër në fshatin ku banon dëshmitari.[4] Herën e dytë, hetuesi i Prokurorisë takoi këtë të afërm dhe ai i tha se dëshmitari nuk dëshironte të fliste me Tribunalin dhe se ai nuk dinte asgjë në lidhje me subjektin për të cilin duhej të dëshmonte.[5]

2. Më 25 maj 2007 Dhoma lëshoi urdhërparaqitjen e kërkuar për dëshmitarin ("Urdhërparaqitje") që e urdhëronte atë të paraqitej si dëshmitar para kësaj Dhome më 14 qershor 2007 dhe e informonte për pasojat e mosbindjes së qëllimshme pa arsye ndaj Urdhërparaqitjes

3. Më 12 qershor 2007 një përfaqësues i UNMIK-ut paraqiti një Fletë-Dorëzimi të urdhërparaqitjes ("Fletë-Dorëzimi"). Sipas këtij dokumenti Shërbimi Policor i Kosovës ("SHPK") e kishte takuar dëshmitarin dhe i kishte dorëzuar urdhërparaqitjen. Dëshmitari i kishte thënë SHPK-së se ai e kuptonte përmbajtjen e dokumentit mirëpo ai nuk ishte i gatshëm të vinte në Hagë për të dëshmuar.[6] Arsyet e dhëna nga dëshmitari për refuzimin ishin se nuk kishte çfarë të shtonte më shumë nga çfarë u kishte thënë hetuesve të Prokurorisë dhe se kishte probleme shqetësuese shëndetësore, ndër të cilat "probleme me zemrën, tension të lartë, dhe probleme me sytë të cilat janë shumë serioze".[7] Për më tepër Shefi për Mbrojtjen e Dëshmitarëve i SHPK-së raportoi në një shkresë të veçantë prej Fletë-Dorëzimit se "Kur e takova dëshmitarin nuk të mos përmend faktin se personi është në gjendje të dukshme të keqe shëndetësore".[8]

[1] Dëshmitari ka numrin 74 në urdhëresën e përkohshme për dhënien e dëshmisë në listën e dëshmitarëve të Prokurorisë të 20 qershorit 2007.
[2] Prosecution Application, Annex A/Kërkesë e Prokurorisë, Shtojca A.
[3] Po aty, paragrafi 9, Shtojca A.
[4] Po aty, Shtojca A.
[5] Po aty, Shtojca A.
[6] Memorandum, p.1/Fletë-Dorëzimi, f.1
[7] Po aty, f.1
[8] Po aty, f.3.

4. Më 21 qershor 2007, Seksioni për Viktima dhe Dëshmitarë të Tribunalit ("SVD") e informoi Dhomën se një përfaqësues i SVD-së kishte vizituar shtëpinë e dëshmitarit. Sipas SVD-së dëshmitari nuk ndodhej në shtëpi në atë moment. Një i afërm i dëshmitarit i tha përfaqësuesit të SVD-së se dëshmitari nuk do të pranonte kurrë të dëshmonte vullnetarisht, madje as me videolidhje. I afërmi gjithashtu tha se dëshmitari nuk kishte pasaportë dhe ishte shumë i sëmurë për të udhëtuar.

5. Më 29 qershor 2007 SVD-ja informoi Dhomën se një përfaqësues i SVD-së kishte kontaktuar drejtpërdrejtë me dëshmitarin. Sipas shënimeve të përfaqësuesit të SVD-së të marra gjatë kontaktit, dëshmitari deklaroi se ai "nuk mund të thoshte se është i gatshëm të dëshmojë mirëpo gjithashtu nuk dëshiron të thotë përfundimisht se nuk do të dëshmojë" dhe se tash kishte dhënë arsye në lidhje me mungesën e dëshirës për të mos dëshmuar dhe dëshironte që ato të merreshin parasysh. Gjithashtu ai deklaroi se nuk kishte pasaportë të vlefshme dhe ishte me shëndet të ligët ("tension i lartë, probleme të zemrës").

6. Më 16 korrik 2007 Dhoma ftoi Prokurorinë që të informojë Dhomën nëse ajo duhet të urdhërojë Prokurorinë për nisjen e procedimit të një dëshmitari për shpërfillje ("Ftesa e Dhomës"). Dhoma kërkoi prej Prokurorisë që të shqyrtojë rrethanat e dëshmitarit, "ndër të cilat vlerën e dëshmisë së tij, ndikimin e mundshëm prej mosbindjes së tij ndaj dëshmitarëve të tjerë të mundshëm, dhe pasojat praktike në lidhje me burimet e hetimit për shpërfillje".[9] Më 30 korrik 2007, Prokuroria i kërkoi Dhomës që të nxjerrë një urdhëresë që Prokuroria bazuar në Rregullën 77(C)(i) të Rregullores së Procedurës dhe Provave të Tribunalit të hetojë çështjen me synim përgatitjen dhe paraqitjen e aktakuzës për shpërfillje ("Këshilla e Prokurorisë"). Gjithashtu u kërkua që kjo urdhëresë të jetë publike.[10]

7. Rregulla 77(A) përcakton se Tribunali mund të konsiderojë si shpërfillës personat të cilët me vetëdije dhe qëllimisht ndërhyjnë në ushtrimin e drejtësisë, duke përfshirë edhe ata persona të cilët pa arsye nuk i binden urdhrit për t'u paraqitur para Dhomës. Paragrafi C(i) i të njëjtës Rregull përcakton se kur Dhoma ka arsye që të besojë se një person po e shpërfill Tribunalin, ajo e urdhëron Prokurorinë ta hetojë çështjen me synim përgatitjen dhe paraqitjen e aktakuzës për shpërfillje.

[9] Chamber Invitation/Ftesa e Dhomës, paragrafi 7.
[10] Prosecution Advice, para 7/Këshilla e Prokurorisë, paragrafi 7.

8. Informacioni i marrë deri tash në lidhje me këtë çështje prej Dhomës dhe i përmbledhur më sipër i jep Dhomës arsye që të besojë se dëshmitari në fjalë është shpërfillës ndaj Tribunalit.

9. Rrjedhimisht në bazë të Rregullës 77, Dhoma,

**URDHËRON** Prokurorinë që të hetojë refuzimin e dëshmitarit për paraqitje për të dëshmuar me synim përgatitjen dhe paraqitjen e aktakuzës për shpërfillje.

Përpiluar në anglisht dhe frengjisht; teksti në anglisht ka përparësi.

/nënshkruar në origjinal/
Gjykatës Alphons Orie
Kryegjykatës

Sot, më datën 7 shtator 2007
Në Hagë
Holandë

**[Vula e Tribunalit]**